

Dalës-lizena

Nr. -1-64
Br.

Data 05.06.2020
Datum

OBILIQ-OBILIC



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 44 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 6 të Udhëzimit Administrativ nr. 02/2015 (MAPL) për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës si dhe nenit 49 të Statutit të Komunës, bazuar në kërkesën e Kryetarit të Komunës, nr.-II-516, të dt.05.06.2020, caktoj:

Mbledhjen e Jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës me dt. 10.06.2020 (e mërkurë) në ora 10:00, në sallën e Kuvendit komunal me këtë:


REND DITE

1. Rishikimi i buxhetit për vitin 2020.



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim Gërguri
Burim Gërguri



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO			
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo			
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije / Ministry of Finance			
Arkiva - Arhiva - Archiv			
Nr. Urdhri Cirk. Indir. Cirk. Urdh.	01	Nr. Prot. Dok. Prot. Prot. No.	615
Nr. i Hapësirës Broj. Shtetërore No. P. 00000000	✓	Data Datum Date:	05/06/2020
Përqendrimi			

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Financave dhe Transfereve / Ministarstvo za Finansije i Transfere/ Ministry of
Finance and Transfers

Zyra e Ministrit / Kancelarija Ministra / Cabinet of Minister

DATE/A:	05.06.2020
REFERENCË:	
PËR/ZA/TO:	Kryetarët e Komunave
CC:	Drejtorët e financave / Zyrtarët Kryesorë Financiar
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hykmete Bajrami, Ministri e Financave
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Instrukcioni për Rishikim të buxhetit për vitin 2020

Të nderuar,

Duke u mbështetur në Ligjin për Menaxhim të Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Nr. 03/L-048, Nenin 20.8, 22 dhe 25, dhe në Nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Qeveria do të përgatisë dhe propozojë Kuvendit amendamentet për plotësim - ndryshimin e Ligjit nr. 07/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020.

Qeveria e Republikës së Kosovës planifikon të rishikojë buxhetin për vitin 2020 duke ruajtur neutralitetin buxhetor, në kuptim të kufijve të përgjithshëm të shpenzimeve për të siguruar stabilitetin buxhetor si dhe sigurimin e mjeteve financiare për zbatimin e masave të pakos emergjente fiskale për arsye të pasojave të pandemisë COVID-19.

Nga organizatat buxhetore në nivel lokal kërkohet të identifikojnë rregullimet e brendshme në kuadër të organizatës buxhetore për të siguruar kryerjen e obligimeve lidhur me zbatimin e masave të pakos emergjente fiskale.

Kërkesat për rishikim të buxhetit nga ana e organizatave buxhetore duhet të dorëzohen në Ministrinë e Financave dhe Transfereve, në Departamentin e Buxhetit, jo më larg se të mërkurën më 10 qershor 2020. Ju lutemi kontaktoni analistin tuaj të buxhetit nëse keni nevojë për informata shtesë.

Sinqerisht,
Hykmete Bajrami




Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova




Komuna e Obiliqit - Opština Obilić - Municipality Obiliq

Datë/Data/Date	05/06/2020
Nga/Od/From:	Kryetari i Komunës së Obiliqit z. Xhafer Gashi
Për/Za/To:	Kryesuesin e Kuvendit Komunal z. Burim Gërguri
Tema/Subjekat/Subject:	Kërkesë për Rishikim të buxhetit për vitin 2020



I nderuar

Duke u bazuar në kërkesën e Ministrisë së Financave për rishikimin e buxhetit për vitin 2020, kërkoj nga ju që të thirrni mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal.



Dalës i datuar:

Nr. 11-516

Br.

date

datum

05.06.2020

Me respekt!